



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 82/2019

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARIT TË AUTORITETIT
TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE, ZOTIT ZYLYFTAR BREGU**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 21, pika 1, dhe 45, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Zoti Zylyftar Bregu lirohet nga detyra e anëtarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 4.7.2019